



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 prill 2013
Nr.ref.:RK402/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI114/12

Parashtrues

Kastriot Hasi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, të 24 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Kastriot Hasi, nga Gjakova, me banim në Gjakovë, Rr. "A. Mojsiu", p. n.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik është Konkluzioni i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, i 24 janarit 2011, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në kërkesën e parashtruesit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 8 nëntor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, i 24 janarit 2011, me të cilin parashtruesi i kërkesës njoftohet se kjo drejtori ka ndërprerë procedurën për dhënien e lejes për ndërtim të objektit të banimit të lartë kolektiv në ngastrën kadastrale nr. 382/2 dhe në ngastrën kadastrale nr. 382/4, në Zonën Kadastrale Gjakovë-qytet, e që ishte iniciuar me kërkesën e vet z. Hasi.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 dhe neni 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009; dhe rregullat: 54, 55 dhe 56 (2), të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në regjistrin përkatës të Gjykatës, me Nr. KI114/12.
6. Më 11 dhjetor 2012, me Vendimin GJ.R. KI114/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues gjyqtarin Kadri Kryeziu, ndërsa me Vendimin KSH 114/12, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe prof. dr. Enver Hasani (anëtarë).
7. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
8. Më 20 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese pranoi, nëpërmjet postës, dokumentacionin shtesë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, i cili dokumentacion përbëhej nga kopje të planit dhe skica të punuara të parcelave ku parashihej ndërtimi, si dhe të objektit që kishte për qëllim të ndërtonte parashtruesi i kërkesës.
9. Më 6 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 29 maj 2008, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Kastriot Hasi për leje urbanistike dhe të ndërtimit të lartë në qytetin e Gjakovës, nxori Njoftimin nr. 07-351-1956, me të cilin z. Hasi njoftohej se në zonën kadastrale ku ai kishte kërkuar ndërtim të lartë, sipas planit ideor të Komunës, të aprovuar më 29 gusht 2001, në ngastrat kadastrale pronar i të cilave ishte ai, lejohej "ndërtimi i objektit ekzistues plus një etazh". Por, meqenëse z. Hasi kishte kërkuar leje për ndërtim të lartë, Komuna kërkoi

nga parashtruesi i asaj kërkesë plotësim të lëndës: pëlqimin nga fqinjët për ndërtimin e objektit të tij.

11. Komuna kërkoi nga z. Hasi marrjen dhe dërgimin në Komunë të katër pëlqimeve nga fqinjët, dhe atë: 1) Pëlqimin nga Gjykata Komunale në Gjakovë, e cila ishte pronare e ngastrave: nr. 382/1 dhe nr. 383/1, Zona Kadastrale Gjakovë-qytet, dhe që kufizoheshin me parcelën ku z. Hasi mendonte të ndërtonte objektin e tij shumëkatësh; 2) Pëlqimin nga fqinji, i cili është pronar i ngastrës kadastrale nr. 382/3; 3) Pëlqimin nga fqinji perëndimor; dhe 4) Pëlqimin nga fqinji verior, z. Selim Tolaj.
12. Komuna theksoi se marrja dhe prezantimi i këtyre "pëlqimeve me shkrim është kusht primar për shqyrtimin dhe për analizimin e lëndës për vazhdimin e procedurës për dhënien urbanistike dhe lejes së ndërtimit". Më tej, Komuna theksoi se mosprezantimi i këtyre pëlqimeve do të ndikonte që leja e kërkuar të mos jepej.
13. Më 29 maj 2008, z. Hasi kërkoi me shkrim pëlqimin për ndërtim nga fqinji kufizues, Gjykata Komunale në Gjakovë, por mori përgjigje negative me arsyetimin se, sipas planit ideor të qytetit, në ato ngastra nuk lejohet ndërtimi i lartë.
14. Më 30 qershor 2008, Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, nxori Konkluzionin nr. 07/351-1956, me të cilin ndërpritej procedura e iniciuar sipas kërkesës së z. Kastriot Hasi nga Gjakova, për dhënien e lejes për ndërtim kolektiv (të lartë) në Gjakovë, sepse, konform kërkesës së Komunës për plotësim të kërkesës, parashtruesi nuk kishte prezantuar pëlqimet me shkrim për ndërtimin nga fqinjët: Gjykata Komunale në Gjakovë, fqinji perëndimor dhe ai verior, sipas kushteve të cekura në kërkesën e Komunës për plotësim të lëndës.
15. Në Konkluzion u theksua se, në rast të përmbushjes eventuale të kushteve të parashtruara nga Komuna, z. Hasi mund të riaplikojë për leje ndërtimi.
16. Më 6 dhjetor 2010, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës së përsëritur nga z. Kastriot Hasi për leje urbanistike dhe të ndërtimit të lartë në qytetin e Gjakovës, nxori Njoftimin nr. 07-351-8460, me të cilën nga parashtruesi i asaj kërkesë kërkoi plotësim të lëndës: pëlqim nga fqinjët për ndërtimin e objektit të tij, të njëjta sikur ato që u përmendën në paragrafin 11 të këtij aktvendimi.
17. Më 8 dhjetor 2010, z. Hasi paraqiti kërkesë me shkrim në Gjykatën Komunale në Gjakovë, duke kërkuar pëlqimin me shkrim për ndërtimin e objektit të ndërtimit të lartë, sipas kushteve që ia kishte kërkuar Komuna e Gjakovës, dhe prapë mori përgjigje negative me të njëjtin arsyetim se nuk lejohet ndërtimi i lartë në ngastrat ku ai kishte planifikuar ndërtimin.
18. Më 24 janar 2011, për pasojë të mungesës së prezantimit të pëlqimit nga Gjykata Komunale (sepse ndërkohë z. Hasi kishte marrë pëlqimet me shkrim nga fqinjët e tjerë), Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, nxori Konkluzionin nr. 07/351-8460, me të cilin përsëri ndërpritej procedura e iniciuar sipas kërkesës së z. Kastriot Hasi nga Gjakova për dhënien e lejes për ndërtim kolektiv (të lartë) në Gjakovë, sepse parashtruesi i saj nuk kishte vepruar konform kërkesës së Komunës për plotësim të lëndës, duke dështuar të prezantojë pëlqimin me shkrim për ndërtim nga fqinji Gjykata Komunale në Gjakovë.
19. Në udhëzimin juridik të Konkluzionit theksohet se pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, kundër këtij konkluzioni, në afatin 30 ditë nga dita e pranimit të tij.

20. Më 15 nëntor 2012, z. Hasi mori një përgjigje nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, në të cilën përsëritej se Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Këshilli Gjyqësor, në emër të saj, nuk mund të japin pëlqim pozitiv për ndërtimin e objektit të lartë të kërkuar nga z. Hasi, përderisa Komuna e Gjakovës nuk ka një plan të detajuar urbanistik, e plani ideor në fuqi i Komunës në ngastrat kadastrale ku planifikohet ndërtimi nuk lejon ndërtim të lartë, andaj as Gjykata Komunale e as Këshilli Gjyqësor nuk mund të dalin përtej ligjit.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me konkluzionet e Komunës së Gjakovës dhe me njoftimet e Gjykatës Komunale të Gjakovës, atij i është mohuar e drejta e ndërtimit në pronën e tij, edhe pse nuk ka specifikuar drejtpërdrejt se cila e drejtë kushtetuese i është shkelur.
22. Parashtruesi, më tej, thekson se ai e ndien veten viktimë të mospajtimit ndërmjet Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Komunës së Gjakovës, sepse, për pasojë të hedhjes së përgjegjësisë prej njërit organ te tjetri, ai nuk mund ta ndërtojë objektin sikur e kishte planifikuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht duhet të vlerësojë nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.
24. Përkritazi me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
25. Në këtë drejtim, Gjykata konkludon se z. Hasi është qytetar i Kosovës, është individ dhe pretendon se, me konkluzionet e Komunës dhe me njoftimet e Gjykatës Komunale, atij i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Së këndejmi, Gjykata do ta trajtojë kërkesën e tij brenda kornizave juridike të nenit 113.7 (kërkesat individuale) të Kushtetutës së Kosovës.
26. Rrjedhimisht, në përputhshmëri me paragrafin e mësipërm, z. Hasi, para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, do të duhej t'i kishte shteruar të gjitha mjetet juridik në dispozicion dhe të parapara me ligj.
27. Gjithmonë duke marrë për bazë shkresat e lëndës, të ofruara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se pëlqimet e kërkuara nga Gjykata Komunale në Gjakovë janë “dokumentacion i kërkuar në funksion të përmbushjes së kushteve për marrjen e lejes së ndërtimit”, andaj është qartë se kërkesa bazë e parashtruesit ka të bëjë me “LEJEN PËR NDËRTIM” që, sipas legjislacionit në fuqi, e lëshon Komuna.
28. Për të konstatuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, e që janë në lidhmëni me objektin e çështjes së shtruar në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata merr parasysh legjislacionin në fuqi dhe veçanërisht:

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040)

Neni 17
Kompetencat vetanake

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

(.....)

d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit.

Neni 74

Objektivat e shqyrtimit administrativ

Shqyrtimi administrativ i komunave ka objektivat vijues:

...

b) të sigurojë ligjshmëri të aktiviteteve të organeve të vetëqeverisjes lokale.

Neni 76
Autoritet mbikëqyrëse

76.1 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale është autoriteti mbikëqyrës, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e komunave nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme.

Statuti i Komunës së Gjakovës

29. Statuti i Komunës së Gjakovës, gjithashtu, përmban dispozita relevante për këtë çështje dhe sidomos përmban dispozitat në vijim:

Neni 1

Statuti i Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme do të njihet si "Statuti") është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12, pika 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 55

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

(.....)

i) përpunimin e kërkesave për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcaktimin e kushteve urbanistike për zbatimin e PZHK, PZHU, Planeve Rregulluese dhe Planeve tjera të miratuara në Kuvend;

j) të japë shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore, ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parashtruara të ndërtimit – jep pëlqime urbanistike dhe leje urbanistike;

k) lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe përdorimit.

30. Nga dispozitat juridike, të cituara qartë më sipër, Gjykata arrin në përfundim:
- a) Leje të ndërtimit lëshohen nga Komuna (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit);
 - b) Leja e ndërtimit është akt administrativ, i lëshuar nga organi kompetent, me procedurë administrative;
 - c) Në rast të refuzimit të lejes, apo të ndërprerjes së procedurës me konkluzion, sikur në rastin konkret, ka mjet juridik të ankimit;
 - d) Mjeti juridik, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ushtrohet në ministrinë përkatëse, e në rastin konkret, sipas udhëzimit juridik të Komunës, në Konkluzionin nr. 07/351-8460, e 24 janarit 2011, do të duhej të ushtrohej në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMPH).
31. Për më tepër, në rast të marrjes së përgjigjes negative edhe nga MMPH-ja, pala e pakënaqur mund të hapë procedurë për konflikt administrativ në gjykatën kompetente, ku do të shqyrtohej ligjshmëria e akteve administrative.
32. Nga shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi, Gjykata nuk vë në dyshim faktin se këto mjete juridike në dispozicion dhe të parapara me ligj nuk i ka përdorur parashtruesi i kërkesës, z. Hasi, por, në vend të tyre, ka ushtruar kërkesa e ankesa në gjykatë dhe pastaj në Këshillin Gjyqësor, duke insistuar në pëlqimin për ndërtim të objektit nga Gjykata Komunale, sikur i ishte kërkuar nga Komuna e Gjakovës.
33. Gjykata thekson se qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike, i paraparë me ligj, përpos që është obligim kushtetues i dalë nga përkufizimi juridik i nenit 113.7 të Kushtetutës, është gjithashtu edhe që t'u mundësojë autoriteteve vendore, dhe para të gjithash gjykatave apo edhe organeve administrative, për të parandaluar ose për të riformuluar shkeljet e ankimuara të Kushtetutës. Një qëndrim të tillë e mban edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kjo bazohet mbi hipotezën e pasqyruar në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës rendi juridik i brendshëm do të sigurojë një mjet ankimimi efektiv kundër shkeljeve të të drejtave të sanksionuara me Konventë (*Selmouni kundër Francës [DHM], § 74 ; Kudla kundër Polonisë [DHM], § 152 ; Andrášik e të tjerë kundër Sllovakisë [gjyk]*).
34. Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar, krahasuar me sistemet e rregullta vendëse gjyqësore apo edhe administrative dhe është e dëshirueshme që gjykatat kombëtare, ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive, të kenë fillimisht mundësinë të vendosin për çështjet e pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (*Shih vendimin e GJEDNJ-së - A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], § 142*).
35. Në këto rrethana, parashtruesi ankesës nuk ka dëshmuar se i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe të parapara me ligj, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 1, pika a, të Rregullores, gjen se kërkesën duhet ta refuzojë si të parakohshme, dhe:

PËR KËTO ARSYE


Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në mbështetje të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 6 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Dr. sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani